MËSIMI BONUS I MISIONIT

Një alternativë nëse nxënësit kalojnë dy herë në stacionin e misionit

Alternativa A: Sfida përreth botës

Mjetet:

- Hartë e botës ose glob (nga një për skuadër)
- Shkronja/forma me magnet
- Mur magnetik*
- Etiketa shpërblyese ose një ushqim tipik nga një vend i botës (për skuadrën fituese)

***Ide alternative nëse nuk keni mur magnetik:**

- Kërkoju skuadrave të përdorin shkronja apo forma magnetike për të formuar emrat në dysheme ose në tavolinë (mund të përdorni edhe kartonë ose letra).
- Kërkoju skuadrave të përdorin kruajtëse dhëmbësh ose shkopinj të vegjël për të formuar emrat në dysheme ose në tavolinë (mund të përdorni edhe kartonë ose letra).
- Kërkoju skuadrave të krijojnë një poster ose një karton të madh me vargun nga Gjoni 3:16 dhe emrat e shteteve të ndryshme nëpër botë. Shpërble me etiketa shpërblyese skuadrën që ka posterin më krijues ose atë që ka posterin me më shumë shtete. (Përcakto paraprakisht kriterin e skuadrës fituese.)

Udhëzime:

1. Ndaji nxënësit në skuadra.
2. Jepi secilës skuadër nga një hartë të botës.
3. Thuaj: A e gjeni dot se sa shtete ka në botë? (Rreth 200; *Jepi tri etiketa shpërblyese grupit që iu përafrua më shumë përgjigjes së saktë.*) A e dini se Perëndia do çdo person dhe di edhe numrin e fijeve të flokëve të secilit? Ai i do aq shumë, saqë dërgoi Birin e Tij të vetëm që të vdiste për ta. Si e dimë këtë? (Gjoni 3:16 dhe Mateu 10:30; *Jepu tri etiketa shpërblyese nxënësve që përgjigjen saktë.*) Kjo do të thotë se, pavarësisht se ku shkon në këtë botë, Jezusi vdiq për ata njerëz. Pyetja është: A e ka dëgjuar çdo njeri lajmin e mirë të Jezusit? Le të ndalemi e të mendojmë për shtetet nëpër botë. Për ta bërë këtë, do të bëjmë "Sfidën përreth botës". Qëllimi juaj si skuadër, është të shkruani sa më shumë emra shtetesh të mundeni, duke përdorur format apo shkronjat magnetike, brenda 8 minutash. (Ndihmesë: Nxënësit mund të kërkojnë shtete me pak shkronja.)
4. Skuadra që ka shkruar më shumë shtete, do të fitojë tri etiketa shpërblyese për çdo anëtar.
5. Pasi të shpallet skuadra fituese, kërkoju nxënësve të zgjedhin një shtet për të cilin të luten. Lutuni që Perëndia t'i mbrojë të krishterët në atë vend dhe që ungjilli t'u shpallet qartë të gjithë njerëzve.

Alternativa B: Sfida përreth botës

Printo një kopje të flamujve të ndryshëm për secilën skuadër. Duke përdorur format magnetike, kërkoju skuadrave të krijojnë sa më shumë flamuj të munden, duke përdorur ngjyrat e duhura.